

1. Funkzioni dhe objektivate e AMVV

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është një institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme. Misioni i Agjencisë konsiston në një përfaqëse gjithëpërfshirëse ndaj procesit të decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore në përputhje me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore. Agjencia është e përfshirë në propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore që impaktojnë drejtpërdrejtë, shërbimet dhe kompetencat e çështjeve vendore. AMVV është një institucion qendror koordinues në mbështetje të qeverisjes vendore për zgjidhjen e problematikave dhe vështirësive që shfaqen gjatë ushtrimit të funksioneve prej tyre. Gjithashtu ajo ka për detyrë të evidentojë dhe përgjithësojë praktika të veçanta të suksesshme nga njësi të veçanta të qeverisjes vendore. Ndërkohe ajo shërben si hallkë ndërmjetëse midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për përmirësimin dhe pasurimin e legjislacionit në funksion të rritjes së nivelit të shërbimeve që ju ofrohen komuniteteve.


Në këtë funksion AMVV kryen edhe detyrën e sekretariatit teknik të Këshillit Konsultativ, ndërmjet Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, një organizëm që ka për funksion të konsultojë akte, strategji të qeverisjes qendrore që afektojnë vetëqeverisjen vendore, risi që ka bërë të mundur përfshirjen e njësisë të vetëqeverisjes vendore në diskutimet me vendim-marrësit me qëllim përafrimin sa më të mirë të vendim-marrjes me hapësirat për zgjidhjen e problemeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Agjencia luan një rol shumë të rëndësishëm në koordinimin e projekteve të financuara nga donatorë të huaj dhe qeveria shqiptare në nivelin vendor, me qëllim rritjen e efikasitetit të përfundimeve apo rekomandimeve që dalin nga realizimi i këtyre projekteve. Në fokusin e AMVV është mbështetja dhe pjesëmarrja në projekte që synojnë përfaqësimin e metodave të qeverisjes vendore me standartet më të mira evropiane, si një komponent i rëndësishëm i procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Me iniciativën e Agjencisë ose nën kujdesin e saj janë në proces përfundimi ngritja dhe funksionimi i zyrave me një ndalesë (OSSH), të cilat përmirësojnë ndjeshëm nivelin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe unifikojnë praktikën në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Një vëmendje të veçantë, Agjencia i kushton konsolidimit të proceseve të realizuara të decentralizimit në kuadër të Strategjisë për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020. Për këtë qëllim nga ana jonë janë organizuar takime, trajnime, seminare dhe konferenca me synim evidentimin e arritjeve dhe rritjen e aftësisë të punonjësve të bashkive për konsolidimin e ushtrimit të funksioneve të decentralizuara.

Për realizimin e misionit të saj, AMVV është në kontakt të vazhdueshëm me drejtuesit dhe stafet e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe të institucioneve të ndryshme të qeverisjes qendrore, me synim mbështetjen e tyre për adresimin e të gjitha problematikave dhe sfidave në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave qeverisëse.

2.Struktura (Organigrama)



3.Struktura e pagave (sipas klasave)

Drejtori i Përgjithshëm II-a

Përgjegjës Sektor (3) III-a/1

Specialist (10) IV-a

Kuadri ligjor rregullator

Tekset e plota

1.VKM nr 83 , datë 28.01.2015, si dhe të VKM –së nr 11, datë 12.01.2018 të Këshillit të Ministrave për “ Krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe zbatimin e Reformës Territoriale”

2.Urdhër nr.17 datë 18.01.2021 për “Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”

3. Rregullore e Brendshme (në proces rishikimi)

E drejta për tu informuar
dhe për tu ankuar

- 1.Koordinatori : Renald Troka
- 2.E-mail : renald.troka@mb.gov.al
- 3.Tel : 0685579966
- 4.Adresa : Bulevardi Zhan d'Ark, Ish Shtëpia e Ushtarakëve, Kati VII, Tiranë – Shqipëri
- 5.Format kërkesë

Mekanizmat kontrollues
dhe monitorues që
veprojnë mbi AMVV

- 1.Raporti javor e mujor
- 2.Raporti i Auditit nga Ministria e Brendshme dhe KLSH

Informacion mbi buxhetin
dhe të dhënat financiare

1. Buxheti 29,000 mijë/lekë
2. Paga dhe Sigurime: 17,000 mijë/lekë
3. Shpenzime Operative : 12,000 mijë/lekë

Informacion mbi
proçedurat e prokurimit

1. Lista e kontratave (Punonjëse pastrimi)
2. Regjistri i parashikimeve për prokurimet (9 prokurime)
3. Nga këto të realizuara (3 të realizuara)

Shërbime që ofrohen nga
AMVV

AMVV nuk ofron shërbime

Proçedurat/mekanizmat për të
dhënë mendime lidhur me proçesin
e hartimit të akteve ligjore
/nënligjore, politikave publike apo
në lidhje me ushtrimin e
funksioneve të AMVV

1. AMVV nuk harton akte
2. Konsultimi në Këshillin Konsultativ (konsulton projektakte që afektojnë vetëqeverisjen vendore)

Sistemi i mbajtjes së
dokumentacionit, llojet dhe format
dokumentuese

- 1.Korrespondenca zyrtare
- 2.Forma shkresor elektornike (e-mail)

Regjistri i Kerkesave dhe
pergjigjeve

Urdhër nr.188 datë 18/12/2020 për “Miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuara”

Ndihma shoqërore/
subvencione të dhëna nga
AMVV

Nuk aplikohen nga AMVV

Informacione/dokumente që
kërkohen me shpesh dhe ato që
grykohen të dobishme për publikim
nga AMVV

Nuk ka